



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-152

**PËR RITJEN E KUOTËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË
FONDIN MONETAR NDËRKOMBËTAR**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR RITJEN E KUOTËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË
FONDIN MONETAR NDËRKOMBËTAR**

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë autorizimin për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar, të propozuar nga Bordi i Guvernatorëve më 15 dhjetor 2010 me Rezolutën nr. 66-2.

Neni 2

Kuota e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar do të rritet nga pesëdhjetë e nëntë presje zero (59,0) milionë të drejta speciale të tërheqjes (DST) në tetëdhjetë e dy presje gjashtë (82,6) milionë DST.

Neni 3

Për zbatimin e këtij ligji në pajtim me procedurat në fuqi është përgjegjëse Qeveria e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-152
01 nëntor 2012

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI